ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-10280-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **TRANSPORTI I PUNETOREVE TE KEK-ut**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Dita Travel SH.P.K.**
NUI	**811944132**
Adresa	**BATLLAVË**
Vendi	**BATLLAVË**
Kodi postar	**-**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**HAJDAR DILI**
Adresa elektronike	**dita.travel@hotmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**11.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Transporti i punëtorëve të KEK-ut relacioni Prishtina-1 Prishtina-2 Podujeva dhe Ferizaj[]Transporti i punëtorëve te KEK-ut relacioni Skenderaj-Drenas

Një ankesë kundër: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:.KEK-23-10280-2-1-1

Sa i përket tenderit për TRANSPORTI I PUNETOREVE TE KEK-ut , LOT 1 Transporti i punëtorëve të KEK-ut relacioni Prishtina-1 Prishtina-2 Podujeva dhe Ferizaj- KEK dhe anasjelltas LOT 3 Transporti i punëtorëve te KEK-ut relacioni Skenderaj-Drenas- KEK dhe anasjelltas.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Për aktivitetin e prokurimit "TRANSPORTI I PUNETOREVE TE KEK-ut, LOT 1 Transporti i punëtorëve të KEK-ut relacioni Prishtina-1 Prishtina-2 Podujeva dhe Ferizaj- KEK dhe anasjelltas LOT 3 Transporti i punëtorëve te KEK-ut relacioni Skenderaj-Drenas- KEK dhe anasjelltas.

AK KEK me datën 25/09/2023 ka publikuar Njoftimin për kontrate

Data 06/11/2023, ka qene afati i fundit për ofertim

Referuar procesverbalit te hapjes ne aktivitetin e prokurimit te cekur i me lart kanë

ofertuar gjithsejt 13 operator ekonomik.

Duhet sqaruar se aktiviteti i prokurimit në fjale është i ndare në Lote dhe ne parashtrojmë ketë ankese për Lotin 1 dhe 3.

Me datën 25/03/2024 AK ka publikuar Njoftimin për dhënie te kontratës, dhe referuar këtij Njoftimi shihet se për Lot1, i rekomanduar për dhënie te kontratës është OE Flutura Reisen O.P, me çmim prej 1,829.566.02€. Ndërsa për Lot 3, OE Bujar Dervishi B.I me çmim prej 380.581.20€.

Kundër vendimit te cekur si me lart, e datën 29/03/2024, kemi parashtruar kërkesë për Rishqyrtim ne AK dhe me datën 02/04/2024 AK merr vendim me te cilin e refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim duke e lenë ne fuqi vendimin e tyre te datës 21/03/2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me rastin e zhvillimit te aktivitetit te prokurimit ne fjale AK ka bere shkelje te dispozitave te Ligji Nr. 04/L-042 Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L 068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si:

Shkelje e nenit 1 – Qëllimi (LPP)

Shkelje e nenit 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi (LPP)

Shkelje e nenit 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave (LPP)

Shkelje e nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (LPP)

Shkelje e nenit 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës Ligji Nr. 04/L-042 Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L 068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fillimisht duhet te sqarojmë, se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit te kompanisë sonë nga aktiviteti i prokurimit ne fjale sipas Letrës standarde te dërguar nga AK KEK ngase ne kemi ofruar te gjitha dëshmitë sipas kërkesës se AK-së dhe Njoftimit për kontratë dhe kemi ofertuar me çmim me te lire për te dy Lotet.

Ne vijim do t'i parashtrojm argumentimet ligjore dhe faktike; se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore te Ligji Nr. 04/L-042 Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L 068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, me rastin e zhvillimit te aktivitetit te prokurimit ne fjale.

Neni 1 i LPP-së , Qëllimi i këtij aktiviteti nuk është respektuar.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi (LPP) , Në këtë aktivitet nuk është respektuar neni 7, pasi që nuk janë trajtuar të gjithë OE , të barabartë duke mos respektuar edhe nenet tjera të LPP, duke shkaktuar një diskriminim dhe një favorizim te hapur për OE -te pjesëmarrës ne aktivitetin e prokurimit ne fjalë.

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të ofertave në kundërshtim me Nenin 59 e jo në përputhje me Nenin 59 .

Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënien e Kontratës Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të ofertave në kundërshtim me Nenin 60 e jo në përputhje me Nenin 60 duke bërë shkelje flagrante të këtij Neni neve që e plotësojmë këtë Nene saktësisht paragrafin 1 i cili thotë: citojmë paragrafin 1 të Nenit 60 të LPP-s ("1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji"). Në rastin konkret kushti për shpërblimin me kontratë ka qenë: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, që ka të bëjë me piken 1.1 të këtij Neni.

Ndërsa, Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljet LPP-se duke e rekomanduar për kontratë operatoret ekonomik për LOT 1 dhe LOT 3, qe te njëjtit nuk kanë plotësuar kërkesat e

nenit 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, konkretisht, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2,

<u>Pretendimi për OE FLUTRA REISEN OP Lot 1</u>

F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK 4/3 Lot 1.

OE FLUTRA REISEN OP nuk ka plotësuar kërkesat e AK, ku AK ka kërkuar:

KERKESA E DOSJES b) Shofer te kategorisë "D".....27 persona Te dëshmohet me kopje te patentë shoferit, kontrate pune apo para kontratë OE i rekomanduar për kontratë ne LLOT 1 ka prezantuar shofer te kategorisë D te cilët gjithsej 13 prej tyre me afat te skaduar. Kusht i pa plotësuar .

Konsiderojmë dhe vlerësojmë, se me rastin e pranimit te kriterit te lartcekur si te plotësuar nga ana e AK për OE në fjale vërehet një favorizim i këtij Operatori ekonomik në relacion me neve si kompani tenderuese sepse neve eliminohemi se gjoja kemi ofertuar me dokumente pa validiteti ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës shpërblehet me kontrate edhe përkundër faktit se dokumentet e njëjta i ka pa validitet.

Ne rastin konkret AK nuk arrin te menagjoj ne mënyrë efikase me paranë publike dhe nuk vepron drejt me parimin baze te nenit 1 te LPP-së, duke i ikur qëllimit për te cilin prokuron aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe në te njëjtën kohe duke e shkelur në mënyrë te hapur nenin 7 te LPP-së duke e favorizuar OE te rekomanduar për dhënie te kontratës dhe duke na diskriminuar neve si OE serioz për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Sqarojmë se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës për Lot 1 nuk ka plotësuar: KERKESEN E DOSJES b) Minibus (mbi 18 ulëse)..... 3 cope Te dëshmohet me kopje te librezës se qarkullimit dhe kopje te certifikatës se kontrolles teknike të lëshuar nga organet kompetente brenda afateve ligjore Lot 1. OE FLUTRA REISEN OP ,

Sepse për kërkesën e cekur si me lart OE FLUTRA REISEN OP ka prezantuar 3 minibus me marrëveshje te cilët asnjeri nga ta nuk e plotëson kushtin pasi që te gjithë janë maksimum 18 ulës e jo siç është kërkuar b) Minibus (mbi 18 ulëse)..... 3 cope.

Duhet te i referohemi faktit se në pajtim me nenin 59 te LPP-së për kontratë mund te rekomandohet vetëm një OE i përgjegjshëm i cili ka plotësuar kërkesat e dosje se tenderit dhe njëkohësisht është edhe me çmim me te ulët. Ne rastin konkret vërehet hapur se OE i

rekomanduar për dhënie te kontratës Lot 1 nuk ka plotësuar kërkesat e cekura si me lart dhe si rrjedhojë e këtij fakti AK është dashur që ofertën e te njëjtit OE ta vlerësoj si te pa përgjegjshëm e jo te njëjtin ta shpërblej me kontratë duke vepruar ne kundërshtim me nenin e cekur si me lart dhe njëkohësisht duke i injoruar kërkesat e vendosura vet në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate.

Mos plotësimi i kërkesës së cekur si më lart nuk mund te vlerësohet si devijim i vogël sepse kërkesa e lartcekur është kërkese rrënjësore që ja determinon kushtin kryesor te AK-së ngase vet AK ka pasur nevoja për ketë lloj te minibusit me vet faktin se ka hartuar specifika sipas kërkesës së cekur si me lart andaj duke ju referuar përshkrimit te kërkesave dhe specifikave te AK-së te njëjtit nuk mund te konsiderojnë devijim te vogël një kërkese qe detyrimisht është dashur te plotësohet nga ana e OE-ve pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit ne fjalë, kur dihet fare qarte se çka realisht mund te konsiderohet si devijim i vogël sipas LPP-se, qe ne asnjë mënyrë nuk hynë dëshmia e munguar ne rastin konkret.

Përfundimisht vlerësojmë se AK me rastin e vlerësimit dhe rekomandimit për dhënie te kontratës për Lotin 1 ka vepruar në kundërshtim me nenin1,7dhe 59 të LPP-së dhe se ekzaminimin , vlerësimin dhe krahasimin e ofertave e ka bere ne kundërshtim me dispozitat ne fjale.

Pretendimi për OE BUJAR DERVISHI B.I Lot 3

Sqarojmë se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës për Lot 3 nuk ka plotësuar KERKESEN E DOSJES : 2.Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik . b) Minibus (mbi 18 ulëse)..... 1 cope

Është fakt i pa kontestueshëm, se OE , i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kushtin e paraqitur me lart : F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK 5/3

Dhe për te vërtetuar ketë fakt OSHP mund ti referohet Provë: Libreza qe dëshmon pretendimin tonë: 1. Minibus me targa: 01-631-UT -- ULSE 17 –është ne kundërshtim me kriterin e dosjes 2. Minibus me targa: 01-572-QJ -- ULSE 18 – Ne kundërshtim me kriterin e dosjes Kriter në dosje ka qenë: Minibus (mbi 18 rekomanduar për kontratë. ulëse)..... 1 cope – Kushte i pa plotësuar nga OE.

Që nuk është plotësuar kriteri i lartcekur nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk është kontestues as vet AK ngase te njëjtit në përgjigjen qe kanë dhënë në vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim ata vet e pranojnë se ky kriter nuk është plotësuar nga ana e OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës, por për AK-në mos plotësimi i te njëjtit kriter te detyrueshëm çuditërisht është vlerësuar si devijim i vogël ngase AK e paska kuptuar në ketë fazë, se kjo kërkesë është menduar ndryshe si kriter.

Arsyeja e dhënien në vendimin e kërkesës sonë për rivlerësim në ketë pike është fare e pa kuptim dhe tregon edhe një vendosmëri akoma me te madhe për te tentuar me çdo kusht qe kontrata te ju jepet këtyre OE-ve te favorizuara nga vet AK.

Andaj kërkojmë nga OSHP që te analizoj në detaje kërkesat dhe dëshmitë e ofruara nga te gjitha palët për aktivitetin e prokurimit në fjale dhe duke besuar në pavarësinë e këtij institucioni shpresojmë qe te ndalohet një diskriminim i tillë për ne dhe një favorizim i hapur i OE -ve te rekomanduar për dhënie te kontratës per aktivitetin e prokurimit ne fjale.

Kërkojmë nga OSHP qe mos te lejoj praktika te këtilla te autoriteteve kontraktuese, duke lejuar qe kërkesat e obligueshme te trajtohen si devijime te vogla për disa OE ndërsa për disa OE te tjerë as qe te merren ne konsideratë sepse ne rastin konkret as qe te behet fjale për devijim te vogël për asnjë dëshmi.

Ju bëjmë me dije se praktikat e tilla në vlerësim rrezikojnë praktika te këqija dhe sjellin rezultate me pasoja te pa riparueshme për sistemin e prokurimit dhe për tregun e Kosovës në përgjithësi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përfundimisht duke ju referuar pretendimeve dhe sqarimeve te dhëna si me lart i propozojmë panelit shqyrtues te Organit Shqyrtues te Prokurimit që ankesa jone te APROVOHET në tërsi si e bazuar dhe

të ANULOHET njoftimin për dhënie të kontratës i datës: 21.03.2024, dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë te kthehet në Rivlerësim, dhe pas Rivlerësimit AK të na shpërblej neve me kontratë pasi që jemi kompani e përgjegjshme me çmim më te lire

si OE- tjerë

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*